

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	28.05.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	13.05.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	27.05.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MIE – Nr. 3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Enea Karakaçi, Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator enea.karakaci@infrastruktura.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim lidhet me barrierat administrative ndaj personave fizikë ose juridikë për t'u pajisur me licencë ose leje në veprimtarinë studimore-projektuese në fushën minerare. Këto barrierat konsistojnë në procedura të gjata, duke filluar nga momenti i aplikimit nga ana e kërkuesit deri në pajisjen e tij me licencë ose leje. Kjo praktike, ka rezultuar jo efektive, duke shkaktuar vonesa.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme me qëllim krijimin e lehtësirave për ushtrimin e lirë të veprimtarisë studimore-projektuese në fushën minerare. Kjo ndërhyrje do të mundësojë reduktimin e barrierave administrative, duke sjellë kështu përmirësimin e klimës së biznesit.

Në këtë kuptim, kjo ndërhyrje do të sjellë ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare pa qenë nevoja e licencimit të personave juridikë e fizikë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e synuara të propozimit janë si më poshtë:

- Të reduktohen barrierat administrative duke hequr licencat e pa nevojshme.
- Të përmirësohet klima e biznesit, duke reduktuar numrin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë minerare.
- Të shfuqizohet licenca “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A, shfuqizimi i së cilës do të sjellë ushtrimin e lirë të veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare.

- Të ulet koha e dhënies së certifikatës për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimëve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës së propozuar, janë shqyrtuar tre opsione:

“**Opsioni 0**” – Ruajtja e “status quo-së”, ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, “ Per sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

“**Opsioni 1**” – Miratimi i një ligji të ri.

“**Opsioni 2**” – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar janë si vijon:

- **Ndikimi ekonomik** (sasior) – Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji nuk kanë ndikim në vlerë monetare.

Ndikimi cilësor – Ndryshimi në projektligjin e propozuar, i cili konsiston në shfuqizimin e licencës së ushtrimit të veprimtarisë studimore-projektuese në fushën minerare, do të ndikojë në:

- a) Reduktimin e numrit të nevojshëm të licencave për veprimtarinë studimore minerare për personat juridik.
- b) Shkurtimin e kohës së ushtrimit të veprimtarisë studimore projektuese në fushën minerare.
- c) Përshpejtimin e vënies në dispozicion të projektit, shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve.

- **Ndikim mjedisor** – Nuk ka ndikim mjedisor.
- **Ndikim social** – Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë social.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 2, ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është opsioni i preferuar. Ky opsion vjen në kuadër të reformës së derregullimit, duke sjellë për biznesin reduktimin e një procedure të konsideruar si të panevojshme në ushtrimin e veprimtarisë së studim-projektimit në fushën e veprimtarisë minerare.

Lehtësimi i mëtejshëm i të bërit biznes, nëpërmjet thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procedurave të trajtimit të licencave, mund të arrihet vetëm me anë të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji nuk kanë ndikim në vlerë monetare, por ndikojnë në lehtësimin e procedurës së trajtimit të licencës.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

2019	2020	2021
------	------	------

Jo e zbatueshme	Jo e zbatueshme	Jo e zbatueshme
<p>KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyt pse?)</i></p> <p>Raporti i VN, së bashku me projektaktin dhe relacionin shpjegues, më datë 28.05.2019, u publikuan në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (në nivel ekspertit dhe qytetari), si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>Pas përfundimit të afatit 20-ditor për dhënien e komenteve, nuk u paraqit asnjë koment/rekomandim.</p> <p>Gjithashtu projektakti u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe më tej për bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë.</p> <p>Nga ana e MIE janë reflektuar komentet e tyre në përmbajtjen e projektligjit dhe relacionit.</p>		
<p>ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i></p> <p>Për zbatimin e opsionit të preferuar ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si institucioni përgjegjës vendimmarrës për kërkesat për pajisjen me certifikatë për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare. MIE gjithashtu do të monitorojë zbatimin e procedurave të parashikuara në ligjin e ri.</p>		

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare në Republikën e Shqipërisë dhe ka për qëllim nxitjen e veprimtarisë minerare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe të konkurrencës së lirë në zhvillimin e kësaj veprimtarie, rritjen maksimale të përfitimit publik nga veprimtaria minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik nga rreziku minerar dhe ai i mbetjeve të industrisë minerare.

Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 është ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 134/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar”.

Referuar këtij ligji personat juridik për fillimin e aktivitetit të studim projektim në fushën minerare duhet të pajisen me licencën “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A. Për pajisjen me këtë licence personi juridik duhet të ketë nënshkruar paraprakisht një kontratë me një person fizik të licencuar për kryerjen e studimeve në fushën e veprimtarisë minerare.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Aktualisht ligji parashikon qe personat juridike për fillimin e aktivitetit të studim projektimit në fushën minerare duhet të pajisen me licencën “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A, ndërkohë për pajisjen me këtë licencë personi juridik duhet të nënshkruajë një kontratë me një person fizik të licencuar për kryerjen e studimeve në fushën e veprimtarisë minerare.

Edhe pse pajiset me licencë personi juridik, studimi kryhet nga personi fizik i licensuar per kete fushe studimi. Nisur nga ky fakt, licensimi i subjektit juridik eshte nje dokumentacion formal dhe shton një hallkë të tepërt licencimi.

Grupet e prekura nga ky propozim janë subjektet juridike që kryejnë veprimtari studimore-projektuese në fushën minerare.

Ky problem është trajtuar në zbatim të reformës së derregullimit.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të krijuar një klimë të favorshme për bizneset nëpërmjet reduktimit të numrit të licencave në fushën e veprimtarisë minerare.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje qeveria shpreson në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndihmojë biznesin nëpërmjet shkurtimit të kohës së fillimit të aktivitetit, si dhe dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Gjithashtu kjo ndërhyrje në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ndikon në përsheptimin e vënies në dispozicion të “studimit” shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve. Në këtë mënyrë shoqëritë e licencuara për shfrytëzimin e mineraleve do të fillojnë nxjerrjen dhe tregtimin e mineralit në një kohë më të shkurtër se më parë.

Ky propozim është vlerësuar në kuadër të objektivit të qeverisë për derregullimin, e cila presupozon lehtësimin e mëtejshëm të të bërit biznes nëpërmjet heqjes së licencave të panevojshme.

Në kuadër të reformës së derregullimit, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen, ndër të cilat edhe licenca “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

1. **Të reduktohen barrierat administrative**, duke hequr licencën e panevojshme, “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.
2. **Të përmirësohet klima e biznesit**, përmes ushtrimit të lirë të veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare sipas parashikimeve në VKM nr. 441, datë 16.6.2011, “Për përcaktimin e kushteve të certifikimit e të licencimit të

- dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për licencimin e veprimtarisë studimore-projektuese në veprimtaritë minerare”.
3. Të ulet koha e dhënies së certifikatës për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Janë identifikuar tre opsione të mundshme, si vijon:

Opsioni 0 status quo - Ky opsion përbën një barrë për biznesin, e cila konsiston në shtim procedurash licencimi, si dhe kohë të shtuar për procedurat e nevojshme të licencimit. Legjislacioni ekzistues nuk parashikon lehtësira në procedurat e aplikimit pranë QKB për marrjen e licencave dhe afatet e tyre janë të zgjatura.

“Opsioni 1” – Miratimi i një ligji të ri. Nuk është konsideruar ndryshimi në tërësi i ligjit duke qenë se të gjitha parashikimet e tij do të mbeten në fuqi dhe shtesat dhe ndryshimet që do të miratohen janë në një masë të vogël. Si e tillë, nuk vlerësohet i nevojshëm propozimi i një ligji të ri.

“Opsioni 2” – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky opsion propozohet në kuadër të reformës së derregullimit, konkretisht duke reduktuar për biznesin një procedurë, e cila është konsideruar si e panevojshme në ushtrimin e veprimtarisë së studim-projektimit në fushën e veprimtarisë minerare.

Përzgjedhja e opsioneve është mbështetur në vlerësimtë karakterit cilësor, pas analizës së të cilit rezulton se në opsionin e dytë konstatohet një ndikim pozitiv duke qenë se redukton barrierat dhe lehtëson klimën e biznesit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsioni i preferuar në varësi të ndikimit prek grupet si më poshtë:

- Ndikim të drejtpërdrejtë.
 - Subjektet Juridike që kryejnë veprimtari studimore-projektuese në fushën minerare
 - Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)
- Ndikim jo të drejtpërdrejtë.
 - Shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve.

Ky propozim ka ndikime të drejtpërdrejta për subjektet juridike në reduktimin e numrit të nevojshëm të licencave për veprimtarinë studimore minerare për personat juridik, si dhe shkurtimin e kohës së ushtrimit të veprimtarisë studimore projektuese në fushën minerare. Gjithashtu në aspektin institucional, ndikimi i ndryshimit konsiston në uljen e numrit të veprimeve të administratës së QKB për dhënien e licencave.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë i këtij ndryshimi është mbi shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve dhe konkretisht në vënien në dispozicion të studimit këtyre shoqërive në një kohë më të shkurtër se koha aktuale e nevojshme. Në këtë mënyrë shoqëritë e licencuara për shfrytëzimin e mineraleve do të fillojnë nxjerrjen dhe tregtimin e mineralit më shpejt se më parë.

Ndryshimi i propozuar me anë të Opsionit 2, nuk ka ndikim në vlerë monetare, për këtë arsye nuk vlerësohen kostot dhe përfitimet që mund të sillte ky ndryshim dhe për rrjedhojë dhe risqet dhe kufizimet.

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen për të arritur qëllimet/objektivat e kësaj politike. Krahasimi është bërë duke u nisur nga numri total i neneve të projektligjit ekzistues dhe nenet që ndryshohen dhe shtohen.

Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është relativisht i ri, i përafëruar plotësisht me: 32006L0021, Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2006/21/KE, datë 15 mars 2006 "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse". Miratimi i një ligji të ri, përveçse do të ishte me kosto të larta dhe kërkonte një kohë të konsiderueshme për t'u përgatitur, ajo çfarë është me e rëndësishme do të prekte çështje sensitive në sektorin minerar. Në përfundim u arrit në konkluzionin që paraqitja e projektaktit të jetë në formën e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i përzgjedhur është opsioni nr 2, për arsyet si më poshtë vijon:

Propozimi për ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vjen në kuadër të reformës së derregullimit, duke sjellë reduktimin për biznesin të një procedure të konsideruar si të panevojshme në ushtrimin e veprimtarisë së studim-projektimit në fushën e veprimtarisë minerare.

Lehtësimit i mëtejshëm i procedurave që lidhen ngushtësisht me biznesin, nëpërmjet thjeshtëzimit dhe lehtësimit të praktikave të trajtimit të licencave, mund të arrihet vetëm me anë të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur njësia përgjegjëse do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila njëkohësisht është njësia përgjegjëse për certifikimin e personave fizikë, si dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila deri më sot është njësia përgjegjëse për dhënien e licencës, “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.

Për zbatimin e këtij opsioni nuk parashikohen pengesa duke qenë se pas ndryshimit të propozuar, e vetmja njësi përgjegjëse për licencimin në këtë fushë është Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të zbatimit të objektivit të politikës do të ndërmarrë masat e nevojshme:

- Ndryshimet në aktet nënligjore që preken nga ky projektligj;
- Informimin e grupeve të interesit të prekura nga ky ndryshim.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim monitorimin dhe zbatimin e opsionit të preferuar, do të komunikojë me komunitetin e biznesit dhe do të mbledhë prej tyre mendime, nëse ka pasur përmirësime në procedurat e të bërit biznes, në zbatim të ndryshimeve që burojnë nga opsioni i përzgjedhur.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, do të miratojë procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare.

Treguesit matës për arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre do të jenë:

- numri i certifikatave të reja të miratuara pas miratimit të projektligjit të propozuar;
- numri i subjekteve juridik që do të regjistrojnë në objektin e veprimtarisë së tyre kryerjen e studim - projektimit në fushën minerare, pas miratimit të projektligjit të propozuar.
- koha e fillimit të aktivitetit të veprimtarisë së studim-projektimit në fushën minerare nga personat juridik.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										

Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			